

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“LEGALE ALBANIA” Sh.p.k.

Sot, më datë 25.01.2024, në bazë të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008, “Mbi tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, me vullnet të plotë e të lirë të shprehur në këtë akt, ortakët e shoqërisë së sapo themeluar LEGALE ALBANIA Sh.p.k. hartojnë këtë statut si vijon:

Neni 1.

Emërtimi i shoqërisë

Emri i shoqërisë është “LEGALE ALBANIA” Sh.p.k.. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, person juridik, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin “LEGALE ALBANIA” Sh.p.k.

Neni 2.

Selia

Selia ligjore e shoqërisë ndodhet në Rruga "Myslym Shyri", DOMUS Residence, suitat 16 – 17, Kodë postar 1001, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë, Shqipëri. Për arsye të aktivitetit të saj mund të regjistrojë edhe seli dytësore brenda territorit të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj jashtë territorit të Shqipërisë të cilat në çdo rast duhet të kenë të njëjtin objekt të aktivitetit tregtar me atë të Shoqërisë dhe të jenë paraprakisht të autorizuar nga organet vendimarrëse të Shoqërisë.

Neni 3.

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është caktuar për një kohë të pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti kur regjistrohet pranë QKB - së Tiranë.

Neni 4.

Objekti i shoqërisë

Shoqëria, përgjithësisht, ka për objekt të aktivitetit tregtar të saj kryerjen e shërbimeve të konsulencës dhe asistencës në fushat e ligjit, tatim taksave dhe gjithashtu promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve shkencore dhe të formimit në këto fusha.

4.1 Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj, veçanërisht:

- kryerjen profesionale të konsulencës dhe shërbimeve duke u përqëndruar veçanërisht te përfaqësimi, asistenca dhe mbrojtja në gjykim, konsulenca ligjore gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në të gjitha fushat e së drejtës që kanë të bëjnë me shoqëritë tregtare, investimet e huaja dhe, gjithashtu, në fushën e taksave e tatimeve. Shoqëria, nëpërmjet ortakëve të saj, të punësuarëve, të asocuarve apo të kontraktuarve rast pas rasti, merr përsipër dhe vë në zbatim asistencën, konsulenca ligjore dhe në fushën e tatim taksave qofshin ato edhe të integruara me njëra - tjetrën në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj sipas fushës së përfaqësimit të dhënë. Pjesëmarrja në projekte dhe/ose mundësi bashkëpunimi, në përputhje me objektin e saj;

1

- Shoqëria mund të kryejë gjithë aktet që i konsideron të nevojshme ose thjesht të duhura për përmbushjen e objektit të aktivitetit të shoqërisë parashikuar në legjislacionin që është në fuqi në atë fushë. Njëkohësisht Shoqëria, nëpërmjet profesionistëve të saj, mund të kryejë aktivitete të formimit profesional ligjor dhe në fushën e tatim taksave që u japin mundësi të interesuarve për tu regjistruar më vonë në Urdhra ose Dhoma profesional.
- 4.2 Të gjitha aktivitetet e shërbimeve duhet të kryhen në limitet dhe në respektim të normave që rregullojnë ushtrimin e tyre dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi. Në Shoqëri mund të pranohen profesionistë të licensuar nga ana profesionale në fushën e ligjit dhe tatim taksave të cilët, përpara se të asociohen, duhet të marrin pëlqimin e organeve drejtuese të Shoqërisë sipas Rregullores në fuqi për të tilla procedura.

Neni 5.

Kapitali i shoqërisë

- 5.1. Kapitali i shoqërisë është 200.000 (dyqindmijë/00) Lek. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 (tre) kuota.
- Kuotat i përkasin:
- Një kuotë, e cila përbën 45 % të kapitalit të shoqërisë, në pronësi të ortakut: Av. Xhesilda Balashi lindur më 15.07.1994 (sipas letërnjoftimit bashkëlidhur);
- Një kuotë, e cila përbën 10 % të kapitalit të shoqërisë, në pronësi të ortakut: Av. Lulzim Alushaj, lindur më 08.12.1977 (sipas letërnjoftimit bashkëlidhur);
- Një kuotë, e cila përbën 45 % të kapitalit të shoqërisë, në pronësi të ortakut: Av. Eva Priska lindur më 28.05.1987 (sipas letërnjoftimit bashkëlidhur);
- Kapitali i shoqërisë mund të rritet ose pakësohet dhe është krejtësisht i likujdueshëm dhe i nënshkrueshëm nga ortaku/ortakët.
- 5.2. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme dhe nga pasuritë e futura në kapital ose që do të futen dhe që janë të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë.
- 5.3. Kuotat e kapitalit janë derdhur nga ortakët në Bankë, në llogarinë rrjedhëse në emër të shoqërisë; derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë.
- 5.4 Të gjitha kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të nënshkruara nga ortakët dhe regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë.
- 5.5 Ortakët kanë të drejtën që të tërheqin kuotën e tyre që kanë depozituar te kapitali i shoqërisë në rast se shoqëria nuk do të regjistrohet në QKB brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të kuotave;

Neni 6.

Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm vetëm nëse rezulton që janë respektuar dispozitat e parashikuara nga ky nen.
- 6.2. Në rast transferimi me akt midis të gjallëve, ortakëve, nëse janë më shumë se një, u takon e drejta e parablerjes. Ortaku që shet duhet t'u bëjë më parë një ofertë ortakëve të tjerë ku do të përcaktohet çmimi i kërkuar për shitjen e kuotave të veta, në vlerën e kapitalit të kontrolluar dhe jo më shumë se dy herë të vlerës së derdhur si kapital në llogarinë e shoqërisë. Në këtë

- rast, secili prej ortakëve, sipas pjesëmarrjes që ka në kapitalin e shoqërisë, mund të ushtrojë të drejtën e parablerjes duke shprehur interesin brenda një afati 10 ditor.
- 6.3. Në rast mosmarrëveshjeje mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të secilës prej palëve të interesuara, do të zgjidhet një ekspert kontabël, me miratimin e asamblesë së ortakëve me shumicë të thjeshtë, që do të përcaktojë çmimin e shitjes, duke u bazuar te vlera e kuotës;
 - 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi zgjedhjen e ekspertit, ky ekspert, me kërkesë të palës së interesuar, do të zgjidhet nga Gjykata e vendit ku ndodhet selia e shoqërisë. Pagesa e ekspertit do të ndahet në mënyrë të barabartë mes palëve që janë në mosmarrëveshje.
 - 6.5. Eksperti duhet të bëjë vlerësimin sipas kriterëve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
 - 6.6. Pas vlerësimit të kuotës nga ana e ekspertit, si shitësi ashtu edhe blerësi kanë të drejtën të heqin dorë përkatësisht nga shitja dhe nga blerja. Në këtë rast shpenzimet për ekspertin do të jenë në ngarkim të personit që heq dorë.
 - 6.7. E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njërit prej ortakëve, brenda afatit të parashikuar nga neni 6.2 i këtij Statuti, i kalon ortakëve të tjerë gjithmonë në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e themelimit.
 - 6.8. Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë ato nëpërmjet një akti noterial ortakëve blerës brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit dhe në rast se vlerësimi është bërë nga eksperti brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e vlerësimit.
 - 6.9. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet dhe të përfundojë me nënshkrimin e akteve të kalimit brenda një periudhe prej tre muajsh duke filluar nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të zgjedhur. Pasi kalojnë pa rezultat afatet e mësipërme, dhe blerësi nuk ka vënë në zbatim këtë të drejtë, shitësi gëzon të drejtën që të transferojë të tretëve kuotat e veta.
 - 6.10. I treti blen kuotën në bazë të një kontratë me shkrim dhe pas miratimit nga ana e Asamblesë së përgjithshme me shumicë të kualifikuar të shoqërisë për veprimin e shitjes.

Neni 7.

Fitimet e shoqërisë

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja vendos, sipas ligjit, ndarjen ose ripërdorimin e fitimeve duke përcaktuar mënyrën në bazë të përqindjeve të nënshkruara dhe të kuotës në pronësi ose një marrëveshje të posaçme midis tyre. Në çdo rast fitimi i shoqërisë dhe ndarja e tij duhet të bëhen vetëm në rast se janë paguar detyrimet e tatim taksave, sipas raportit të përgatitur nga personi i ngarkuar nga Administratori për përgatitjen e pasqyrave dhe bilancit ushtrimor.

Neni 8.

Parashikimet pasurore

Shoqëria do të përdorë dhe do të mbajë pasurinë e saj të grumbulluar. Ajo mund të blejë dhe shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale dhe jomateriale, duke përfshirë këtu të drejtën e shitjes së pasurisë së saj të grumbulluar te të tretët.

Në Republikën e Shqipërisë, shoqëria gëzon të drejta të barabarta me çdo person juridik, shqiptar apo të huaj sipas normativës në fuqi dhe mund të zotërojë kuota/aksione kapital në një subjekt tjetër shqiptar apo të huaj por gjithmonë me objekt dhe aktivitet tregtar të ngjashëm.

Neni 9.

Përgjegjësitë

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe gëzon të drejta e detyrime brenda kufijve të kapitalit të saj. Ortakët marrin përsipër rrezikun e aktivitetit të shoqërisë vetëm brenda limitit të kapitalit të derdhur të shoqërisë. Organi administrativ dhe Asambleja e ortakëve ndajnë përgjegjësitë sipas kompetencave të dhëna nga ligji dhe ky Statut.

Neni 10.

Kontrolli i Shoqërisë, kompetencat e Asamblesë së ortakëve

Janë pjesë e kompetencave dhe detyrimeve të ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që parashikohen dhe rregullohen nga ligji, si edhe ato të renditura në këtë statut. Mes këtyre detyrave përfshihen edhe të mëposhtmet:

1. ndryshimi i statutit;
2. miratimi i buxhetit vjetor, inventarit dhe bilancit vjetor;
3. caktimi dhe revokimi i administratorëve ortakë dhe jo ortakë dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se për zgjedhjen dhe revokimin duhet një arsytim i shprehur;
4. miratimi i huave dhe garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe markës së shoqërisë, vendimarrja i takon Administratorit;
7. rritja dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyerja e punës së administratorëve, duke përfshirë këtu aprovimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi aktivitetin e shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi aktivitetin e shoqërisë;
10. vendimi në lidhje me hapjen dhe mbylljen e degëve, selive dytësore, pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera vendase apo të huaja, përfaqësive ose agjensive të shoqërisë;
11. vendimi për riorganizimin dhe shkrirjen e shoqërisë;
12. vendimi për nisjen e një mosmarrëveshjeje ligjore ose për zgjedhjen e një mosmarrëveshjeje ligjore në të cilën është përfshirë shoqëria duke autorizuar administratorët e shoqërisë për këtë veprim;
13. vendimi për zgjedhjen dhe revokimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël, persona fizikë dhe juridikë;
14. vendimi mbi ndarjen e kuotave dhe mbi anulimin e tyre;
15. vendimi mbi miratimin dhe ndryshimin e rregullave proceduriale për mbledhjet e asamblesë;
16. vendimi mbi delegimin ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
17. vendim për aprovimin e transferimit të kuotave;
18. vendimi për çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose nga statuti;
19. pranimi i çdo lloj vendimi tjetër që nuk i është deleguar një organi tjetër.

Vendimet e asamblesë do të regjistrohen në regjistrin e posaçëm ashtu siç parashikohet nga ligji.

Neni 11.

Thirrja e Asamblesë së ortakëve

Asambleja e përgjithshme mblidhet nga organi administrativ nëpërmjet njoftimit dërguar ortakëve me letër rekomande me vërtetim marrje ose, nëse organi administrativ zgjedh kështu, nëpërmjet

postës elektronike të deklaruar nga ortakët. Adresat e e-mailit të ortakëve janë regjistruar në një bazë të dhënash të dokumenteve të shoqërisë.

Njoftimi për thirrjen e asamblesë duhet të përmbajë, vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet dërguar të paktën 7 (shtatë) ditë para datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrave të mësipërme ajo quhet vlefshmërisht e përbërë dhe ka kuorumin e kërkuar nga ligji kur përfaqësohet i gjithë kapitali i shoqërisë.

Neni 12.

Kuorumi dhe vendimarrja

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja dhe votimi përkatës në asamblatë e përgjithshme mund të bëhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike (mail, skype, video dhe të ngjashme). Në këto raste është e nevojshme prania e sekretarit të mbledhjes i cili zgjidhet rast pas rasti nga ortakët. Secili nga ortakët është i lejuar të përfaqësohet në mbledhjen e Asamblesë së ortakëve nga nje ortak tjetër i shoqërisë apo person i tretë, gjithmonë në bazë të një autorizimi me shkrim duke specifikuar, në raste të veçanta, edhe se si duhet votuar.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dërgohet organit administrativ i cili do e regjistrojë në regjistrin e vendimeve, që do të mbahet në selinë ligjorë të shoqërisë nën kujdesin e organit të mësipërm.

Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme, të shpallura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet t'i nënshtrohen normave të këtij statuti përse i takon kuorunit dhe shumicës për marrjen e vendimeve.

Kuorumi i nevojshëm minimal për të vendosur në asamble është pjesëmarrja e shumicës së ortakëve të cilët më pas vendosin sipas ligjit.

Neni 13.

Administrimi i shoqërisë

Si Administrator i parë i shoqërisë zgjidhet:

Z. Lulzim Alushaj, shtetas shqiptar, në moshë madhore me aftësi të plotë juridike për të vepruar, me profesion Avokat për të gjitha shkallët e gjyqësorit, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të tij personal (sipas letërnjoftimit bashkëlidhur) i cili ka të gjitha kompetencat e plota që të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë pa asnjë kufizim.

Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtën e rizgjedhjes nëse do të zgjidhet përsëri administrator nga asambleja e ortakëve. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë përjashtimin nga detyra përpara përfundimit të mandatit. Administratori mund të japë dorëheqjen përpara përfundimit të mandatit, pasi të njoftojë më parë asamblenë e ortakëve, sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Asambleja e përgjithshme mund të zgjedhë edhe më shumë administratorë deri maksimumi shtatë persona që mund të jenë të çfarëdolloj nënshtetësie dhe që mund të mos kenë lidhje me shoqërinë. Në të gjitha rastet e emërimit të Administratorit/ve ai duhet të jetë me profesion Avokat dhe të jetë i regjistruar rregullisht pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë për të paktën pesë vitet e fundit. Në rast zgjedhjeje të disa administratorëve në detyrë, secili prej administratorëve mund të ushtrojë të drejta të plota përfaqësimi dhe firme, sipas kompetencave që i takojnë, që përcaktohen fillimisht nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, regjistruar pranë pozicionit në regjistrin e QKB-së. Secili prej

tyre do të jetë përgjegjës për përmbushjen e funksioneve që i janë caktuar nga asambleja dhe do të ketë për detyrë t'i njoftojë asamblesë dhe administratorëve të tjerë aktivitetet që ka kryer.

Neni 14.

Detyrat dhe funksionet e administratorit

Administratori kryen, pa asnjë kufizim, detyrat që i janë caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë në këtë statut ose të parashikuara nga ligji. Në rastet e përfaqësimit në çështje jashtëgjyqësore dhe/ose gjyqësore për çfarë do lloj konsulence, akti i përfaqësimit lëshohet gjithmonë në emër të Administratorit të Shoqërisë i cili në çdo rast duhet të jete me profesion Avokat dhe të jetë i autorizuar për përfaqësim në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Mes këtyre detyrave, ndër të tjera, hyjnë edhe këto që listohen më poshtë:

1. Të veprojë dhe të nënshkruajë akte në emër të shoqërisë;
2. Të përpunojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznesi për çdo fillim viti financiar që do të miratohet në asamblesë e përgjithshme të ortakëve;
3. Të përpunojë dhe ti paraqesë për miratim asamblesë së përgjithshme raporte mbi aktivitetin e shoqërisë dhe bilancin e mbylljes së vitit financiar referuar vitit të mëparshëm sipas afateve të përcaktuara nga ligji.
4. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
5. Të marrë përgjegjësinë ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet ligjore ose të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet;
6. Të kryejë gjithë aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
7. Të përfaqësojë shoqërinë te të tretët.
8. Të ngarkojë me mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave të kontabilitetit të shoqërisë me korrektesë dhe saktësi persona profesionistë të punësuar apo kontraktuar.
9. Të kryejë regjistrimet dhe të nisë të dhënat e nevojshme të shoqërisë, siç parashikohet nga ligji.
10. Të kryejë detyra të tjera që ia ngarkon ligji ose statuti.
11. T'i raportojë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e aksioneve specifike që kanë një rëndësi të veçantë në aktivitetin tregtar të shoqërisë.
12. Punësime, rroga, pushime nga puna, masa disiplinore ndaj punonjësve, miratim të kërkesave për dorëheqje nga vendi i punës dhe të ndjekë çdo problematikë në lidhje me to.
13. Zgjedhja e ekonomistëve dhe konsulentëve për problemet e shoqërisë. Ekonomisti përgjigjet rregullisht për treguesit financiarë tremujorë, gjashtë mujorë dhe vjetorë për aktivitetin e kryer nga shoqëria.
14. Të administrojë me korrektesë dhe saktësi shoqërinë.
15. Të arrijë marrëveshje me të tretët brenda kufijve të objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
16. Të aplikojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe të ndjekë zbatimin e saj nga të punësuarit, asocuarit dhe personat që bëhen objekt i zbatimit të saj.
17. Të paguhet për punën që kryen në bazë të marrëveshjes së arritur me ortakët themelues në bazë të një kontrate specifike në formë të shkruar.
18. Të marrë informacion dhe të bëjë propozime për gjithçka që e vlerëson si të nevojshme për shoqërinë.
19. Të kryejë gjithë aktivitetet bankare në lidhje me shoqërinë pa asnjë kufizim.

20. Të thërrase asamblenë e përgjithshme, sipas dhe në zbatim të dispozitave të parashikuara nga nenet 12 dhe 13 të këtij statuti dhe të ligjit nëse nuk përcaktohet shprehimisht në statut.

Neni 15.

Të drejtat e shoqërisë

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë aktivitete ashtu siç përshkruhet në objektin e shoqërisë;
2. të marrë kredi në Lekë ose në valutë të huaj sipas normave ligjore;
3. të përfitojë nga lehtësirat që i njeh ligji shqiptar në lidhje me tatimet e të tjera;
4. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që nxjerr gjatë ushtrimit të aktivitetit;
5. të punësojë punëmarrës vendas ose të huaj;
6. të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me Studio Konsulence në vende të ndryshme të botës dhe të marrë pjesë si aneëtare në organizata të ndryshme në fushat e saj të Konsulencës dhe shërbimeve;
7. të ndajë lirisht valutën e realizuar nga fitimet e veta.;
8. të organizohet, në funksionimin e saj të brendshëm, në formë të asocuar apo forma të ngjashme duke rregulluar këto raporte nëpërmjet kontratave të posaçme e që në çdo rast një kopje duhet të mbahet pranë shoqërisë.

Neni 16.

Detyrimet e shoqërisë:

Shoqëria ka si detyrim të:

1. garantojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të përmbushë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit si edhe detyrimet sipas kontratës ndaj kujtdo punëmarrësi;
4. të pajiset me leje, licenca dhe/ose autorizimet e mundshme, nëse ligji e kërkon, për të zbatuar objektin e aktivitetit tregtar te saj;
5. të respektojë standartet më të larta dhe gjithë rregullat që kanë lidhje me aktivitetin e saj profesional.

Neni 17.

Marrëdhëniet ekonomike dhe financiare të shoqërisë

Gjithë aktiviteti tregtar i shoqërisë për realizimin e objektit të saj pasqyrohet në bilancin e saj ekonomik dhe në pasqyrat përkatëse financiare.

Neni 18.

Dokumentet financiare

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti përpunohet bilanci vjetor i shoqërisë. Në bazë të marrëveshjeve me konsulentë, të zgjedhur nga ana e Administratës së Shoqërisë, dokumentacioni mund të depozitohet përkohësisht pranë selisë së konsulentit. Administratori i Shoqërisë ka kompetencën të vendosë dhe të ndjekë zbatimin e rregullave mbi anonimatën e të dhënave.

7

Neni 19.

Kohëzgjatja e vitit financiar

Viti financiar, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit, fillon më një janar të çdo viti dhe përfundon në datë 31 dhjetor të po atij viti.

Neni 20.

Llogaritë rrjedhëse bankare

Shoqëria, pasi çelen nga Administratori i Shoqërisë, mban një ose disa llogari rrjedhëse në bankë. Llogaritë mund të mbahen në monedhën Lek dhe/ose monedhë të huaj dhe pasqyrohen në librat përkatës të kontabilitetit të shoqërisë. Për hapjen e parë të llogarisë rrjedhëse të shoqërisë autorizohet administratori i parë i zgjedhur.

Neni 21.

Rezerva e domosdoshme

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, shoqëria pasi zbret humbjet e vitit të mëparshëm dhe pasi merr vende të posaçëm, heq mënjandë një pjesë të fitimeve, duke krijuar fondin e "Rezervës së domosdoshme".

Neni 22.

Dispozita të veçanta

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, realizuar sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe mund të pajiset me një markë të vetën apo përdorë një logo të tretë të kontraktuar rregullisht sipas ligjit. Në rast realizimi të një faqeje interneti, ky fakt mund të deklarohet me dëshirë pranë QKB-së.

Neni 23.

Shndërrimi

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri të një lloji tjetër, mund të realizohet me vendim të ortakëve me votim dhe kuorum sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

Neni 24.

Prishja

Prishja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara nga neni 99 i ligjit 9901 datë 14.04.2008 dhe për arsyt e mëposhtme:

- kur përfundon kohëzgjatja e parshikuar në aktin e themelimit;
- me vendim të asamblesë së ortakëve sipas kuorumit të kërkuar nga neni 86 dhe votimin sipas kuorumit të kërkuar nga neni 87 pika 1 e Ligjit nr 9901/2008;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka ushtruar aktivitetin tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i aktivitetit sipas pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 3.5.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të Gjykatës;
- me humbjen e kapitalit të shoqërisë

Në këto raste ortaku i shoqërisë vendos mbi formën e likujdimit dhe përcakton një ose më shumë likujdues duke specifikuar edhe detyrat e tyre. Administratori dhe likujduesi janë përgjegjës për mbrojtjen e pasurisë së shoqërisë derisa ajo t'i dorëzohet personave përkatës fizikë dhe juridikë duke likujduar në radhë të parë detyrimet që shoqëria ka ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshme do të rezultojnë të pamjaftueshme, për likujdimin e detyrimeve të shoqërisë, likujduesi mund t'u kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin plotësisht kuotat që u takojnë nëse nuk janë derdhur deri në atë moment.

Neni 25.

Ligji i aplikueshëm dhe gjykata kompetente

Për gjithë mosmarrëveshjet që mund të lindin mes ortakëve, mes ortakëve dhe shoqërisë dhe mes shoqërisë dhe administratorëve do të jetë kompetent legjislacioni i Gjykatave të Republikës së Shqipërisë dhe do të aplikohen normat ligjore shqiptare.

Neni 26.

Aktet statutore

Statuti hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, ka 26 nene dhe një dispozitë përfundimtare, 9 faqe, dhe me vullnetin e tyre të lirë nënshkruhet rregullisht nga ortakët.


Dispozitat përfundimtare

Për regjistrimin, e këtij statuti, në QKB, në bazë të nenit 26 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për QKB" autorizohet Administratori, apo persona nga ai të autorizuar, që të kryejë veprimet e duhura pranë QKB dhe çdo institucioni tjetër publik.

Shoqëria do të ketë logon, vulën dhe emri i saj së bashku me logon do të mbrohen pas regjistrimit në regjistrin e markave. Përdorimi i tyre nga persona të tretë përpara dhe pas periudhës së regjistrimit autorizon Administratorin apo persona nga ai të autorizuar që të veprojnë për mbrojtjen e tyre.

ORTAKËT E SHOQËRISË

"LEGALE ALBANIA" Sh.p.k.


Av. Lulzim Alushaj

Av. Xhesilda Balashi



Av. Eva Priska

